



K.DH.SH.II.nr.232/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sherremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.Sh “Fati Im” biznes individual, me numër identifikues 810225385, me seli në rr. “Dëshmorët e Lirisë, Gjakovë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Tahir Rrecaj, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati i Shëndetësisë, me seli në Prishtinë, Përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.171/22 të datës 18.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e paditëses Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati i Shëndetësisë, e datës 25.01.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.171/22 të datës 18.09.2023, **Vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin e ankimuar, nën pikën I. të dispozitivit, ka vendosur: Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.Sh. “Fati-Im” dhe anulohet vendimi me nr. 10/K-

42-19 i datës 22.11.2019 dhe vendimi nr. 10/L-063-19 i datës 14.10.2019 të nxjerra nga i padituri Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësor. Nën pikën II. Obligohet i padituri Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësor që paditësit N.Sh “Fati Im” t’ia kthej shumën prej 20,000.00€ (njëzet mijë euro) në emër të gjobës së paguar, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Nën pikën III. Në lidhje me kërkesën për kompensimin e dëmit, paditësi udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil. Nën pikën IV. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar. Në pikën V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, ka ushtruar ankesë, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim Dhoma e Shkallës së Dytë të merr aktgjykim që të aprovohet në tërësi ankesa e të paditurës Ministria e Shëndetësisë/Inspektorati Shëndetësor si e bazuar në ligj, të prish aktgjykimin KA.nr.171/22 të datës 171/22 i datës 18.09.2023 duke vendosur meritorisht, ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar padinë e paditësit NSH “Fati Im” dhe të mbetet në fuqi vendimi me nr.10/K-42-19 i datës 22.11.2019 dhe vendimi me nr. 10/L-063/19 i datës 14.10.2019 i Ministrisë së Shëndetësisë, Inspektorati Shëndetësor.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka paraqitur përgjigje në ankesë me datë 24.01.2024 dhe ka propozuar që të refuzohet ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimimi i ankimuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e ankimuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e të paditësit është e pa-bazuar.

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit ka parashtruar padi për anulimin e vendimit nr.10/K-42/19 të datës 22.11.2019.

Dhoma e Shkallës së Parë, në këtë çështje juridike administrative, me dt. 08.09.2023, mban seancë të shqyrtimit kryesor në prani të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, anulon vendimin e organit të paditur, duke obliguar të paditurin që paditësit t'ia kthej shumën në vlerë prej 20,000.00€ në emër të gjobës së paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm. Me arsyetim se gjykata vlerëson se i padituri paarsyeshëm nuk ka përfillur njoftimin e Bordit për Licencimin e Institucioneve Private Shëndetësore i cili me njoftimin me nr.prot 05-6437 të datës 12.11.2019 i ishte drejtuar Kryeinspektorit Shëndetësor duke e njoftuar të njëjtin në lidhje me vendimin e Inspektoratit Shëndetësor se: “Ndalimi i shërbimit shëndetësor për shërbimin e IVF-së për institucionet private shëndetësore nuk parashihet me dispozitat të konstatuara nga Inspektorati Shëndetësor me Udhëzimin Administrativ nr. 06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor”. Gjykata vlerëson se Inspektorati Shëndetësor ka pasur në diskrecionin e tij që të zbatoj dispozitat e UA 06/2013 për FAM që përcaktojnë gjobat përderisa të njëjtat nuk janë në kundërshtim me nenin 94 të Ligjit për shëndetësi, ndërsa shqiptimi i gjobës që nuk është i përcaktuar në Ligjin për Shëndetësi dhe tejkalon maksimumin e përcaktuar të gjobës tejkalon kufijtë e Inspektoratit Shëndetësor në lidhje me diskrecionin e tyre dhe nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Gjykata konstatoi se e paditura nuk ka argumentuar as në përgjigje në padi as në deklaratimet e përfaqësuesve të tyre në seancën e shqyrtimit kryesor që të jetë plotësuar ndonjëri nga rastet e përcaktuara në nenin 95 të Ligjit për Shëndetësi e të cilat i referohen marrjes së licencës në kohëzgjatje prej 1 viti nga ana e të paditurës. Lidhur me konstatimin se qelizat e dhuruesit janë përdorur transferuar në 2-3 femra e jo vetëm në një pacient siç është paraparë me UA 06/2013 nga dhuruesi/donatori në 16 pranuese femra, gjykata nga provat e dorëzuara nga i padituri nuk arriti të vërtetoj një pretendim të tillë. Gjykata ka konstatuar se paditësi ka pranuar qeliza nga dhuruesi me kodin 18/2019 dhe të njëjtat janë transferuar tek pranueset me kodet 109/2019, 112/2019 dhe 123/2019 pra në këtë rast transferimi është bërë vetëm tek 3 femra pranuese në 16 pranuese siç ka konstatuar nga i padituri. Në nenin 24 përcaktohet kufizimi i shfrytëzimit të qelizave deri në lindjen e më së shumti tre fëmijëve të gjatë, ndërsa në rastin konkret nuk është vërtetuar se paditësi ka bërë transferimin e qelizave të një dhuruesi tek më shumë se 3 pranuese. Lidhur me konstatimin e të paditurit se është bërë kompensimi për dhurim/donacion të qelizave në vlerë nga 2x490 euro, gjykata iu referua nenit 19 të UA nr. 06/2013, ashtu që gjykata lidhur me këtë vlerësoi se paditësi ka vepruar në përputhje me nenin 19 të UA nr.06/2013 për FAM dhe ka bërë mbulimin e shpenzimeve materiale lidhur me transportimin e dhuruesit deri në vendin e

dhurimit, analizat e bëra dhe kohën e humbur. Gjykata shqyrtoi me merita këtë çështje, vlerësoi edhe faktin nëse i padituri ka pasur bazë për shqiptimin e gjobës ndaj paditësit, përkatësisht nëse shkeljet e konstatuara nga inspektorati shëndetësor kanë mbështetje faktike dhe ligjore, nga ku rezultoi se i padituri nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike përkatësisht konstatimet e bëra në procedurën administrative nuk ka arritur ti vërtetoj me prova se të njëjtat qëndrojnë. Andaj nga kjo gjendje e konstatuar nga gjykata në përputhje me nenin 43 lidhur me nenin 46 par. 4 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vetë vërtetoi gjendjen faktike pasi që në bazë të provave të dorëzuara nga paditësi dhe vetë i padituri, ishte e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative dhe duke qenë se të dhënat dhe faktet e administruara gjatë kësaj procedure dhanë bazë të sigurt për këtë gjë, gjykata vendosi vetë për çështjen administrative si në dispozitiv të aktgjykimit lidhur me propozimin e përfaqësuesit të paditësit dhe vendosjen si në pikën III. të dispozitivit të aktgjykimit, në lidhje me kërkesën për kompensim të dëmit paditësi të udhëzohet në kontest civil gjykata e mbështeti në nenin 46 par. 5 të LKA-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 23.2 dhe 49 të LKA, lidhur me nenin 194 të LPK-së, (Ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA), dhe as me shkelje të tjera sipas pretendimeve në ankesë. Kolegji, njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë, vlerëson se vendimi kontestues i të paditurës është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjin për Shëndetësi.

Sa i përket pretendimit se inspektorati shëndetësor në bazë të kompetencës ka nxjerrë vendimin e datës 22.11.2019 duke vepruar konform ligjit në fuqi që rregullon këtë fushë dhe se vendimi i tillë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që është nxjerrë konform dispozitave ligjore të LPPA, respektivisht nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike të kësaj çështje. Këtë pretendim kolegji nuk e aprovon pasi që e paditura në rastin konkret nuk i është përmbajtur njoftimit nr.05-6437 të datës 12.11.2019 të bordit për licencimin e Institucioneve Private Shëndetësore, ku në njoftim lidhur me vendimin e Inspektoratit Shëndetësor është theksuar se “Ndalimi i shërbimit shëndetësor për shërbimin e IVF-së për institucionin privat shëndetësor nuk parashihet me dispozitat me Udhëzimin Administrativ nr.06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor”.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, gabimisht vlerësoi provat e administruara po ashtu gabimisht aplikoi edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditurit.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoj të gjitha pretendimet ankimore por i refuzoi si të pa bazuar pasi që të njëjta pretendime janë shqyrtuar edhe në Gjykatën e shkallës së parë, dhe se gjykata e shkallës së parë për secilën pretendim ka dhënë sqarime, andaj pretendimet e tilla nuk mund të ndikonin për një vendim ndryshe, ngase e paditura me asnjë provë nuk e ka argumentuar pretendimet e tij.

Andaj, mbi këtë gjendje të fakteve Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson, se gjykata e shkallës së parë, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 04/L-102, dhe të LKA-së, dhe nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të paditurës. Pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.232/24, me datë 22.04.2024

Kryetare kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri